KËRKESË
Nr.1304/8, datë 3.10.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstruksioni i pikës së kalimit kufitar Morinë-Kukës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" (sipërfaqet m^2), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (objekti) për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për pasuritë me pronarë të pakonfirmuar, për të cilët bëhet shënimi në kolonën përkatëse "I pakonfirmuar", sqarojmë se këta persona që pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmbëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode